



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë (QKMP)

National Centre of Labour Medicine in Gjakova (NCLM)

Nacionalni Centar Medicine Rada u Đakovici (NCMR)



Prot./Droj prot./Prot No: 1363 Nr. i kësht./Br.sh./No page: 1
Datim/Dat: 12.12.2025 Qakova/Đakovica/Gjakova

Në bazë të nënit 81, paragrafi 1,2,3 dhe 4 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197 dhe Nenit 15 e 16 të Rregullorës (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Njësia e Burimeve Njerëzore në QKMP, pas shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve që aplikuan sipas Konkursit Publik Nr.Prot.1163 të datës 27.10.2025, i cili ka qënë i publikuar deri me datë 25.11.2025, për pozitën Zyrtar i Pranimit të Mallit (1 vend i lirë), publikon:

NJOFTIM PËR TESTIM ME SHKRIM

Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret sipas Konkursit Publik Nr.Prot.1163 të datës 27.10.2025 për pozitën Zyrtar i Pranimit të Mallit, mund t'i nënshtrohen testit me shkrim me datë **15.12.2025**, ditë e Hënë, ora **12:00**, në Biblioteken e ORL-së (Salla e leximit), QKUK-Prishtinë.

- Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të Vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak dhe duhet të realizohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak.
- Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.
- Komisioni i pranimit përcakton peshën e secilës pyetje duke mos kaluar maksimumin prej shtatëdhjetë (70) pikëve.
- Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) minuta.
- Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas vendosjes së Komisionit të pranimit, e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testin me shkrim dhe publikon listën në web faqen e SHSKUK.
- Në test me shkrim ruhet anonimiteti i kandidatëve. Kandidatët nuk lejohet të shkruajnë asnjë shenjë që direkt apo indirekt zbulon identitetin e kandidatit, përveç plotësimit të përgjigjeve për çdo pyetje.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit dhe do t'i nënshtrohen testit me shkrim janë:

Zyrtar i Pranimit të Mallit (1 vend i lirë)

Nr.	Kodi	Emri dhe Mbiemri	Kriteret
1.	1190		I plotëson kriteret
2.	1285		I plotëson kriteret
3.	1288		I plotëson kriteret
4.	1299		I plotëson kriteret

Të gjithë kandidatët me vete duhet të posedojnë: leternjoftimin, numri e protokollit të aplikimit dhe laps-kimik me ngjyrë të kaltër.

